

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



NDËMJET

DHE

**ODËS SË PËRMBARUESVE
PRIVATË TË KOSOVËS**

**DHOMËS KOMBËTARE TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË PRIVATË TË SHQIPËRISË**

Oda e Përmbauesve Privatë të Kosovës dhe Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë të Shqipërisë. (referuar si Palë)

Bien dakord për nënshkrimin e këtij memorandumi bashkëpunimi me qëllim krijimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të shërbimeve përmbaimore private respektive, zgjerimin e mundësive për projekte të përbashkëta të ndihmës reciproke dhe inkurajimin e nismave me qëllim ngritjen profesionale të përmbauesit gjyqësor privat.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët për shkëmbimin e praktikave dhe modeleve reciproke në kuadër të një legjislacioni procedural të ngjashëm.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e promovimit të shërbimit përmbaimator përtej kufijve shtetërorë dhe me besimin tek vlerat më të mira juridike dhe morale të këtij profesioni.

Janë të lidhur me këtë memorandum bashkëpunimi me përmbajtjen e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

Palët do të jenë pjesë e një bashkëpunimi me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira nëpërmjet:

- a) Shkëmbimit të modeleve më efikase përbarimore procedurale dhe materiale.
- b) Hartimi me konsulencë të ndërsjellët i strategjive për zgjerim dhe konsolidim të shërbimit përbarimor;
- c) Trajnime profesionale dhe suport në hartimin e kurrikulave dhe programeve mbështetëse akademike;
- d) Përfshirje në aktivitetet e përbashkëta dhe të veçanta promovuese të profesionit përbarimor;
- e) Inkurajimi i çdo nisme tjetër që ka qëllim zhvillimin e profesionit të përbaruesit.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Me qëllim zbatimin me korrektësi të këtij memorandumi, Palët angazhohen:

- a) Të realizojnë projekte të përbashkëta me qëllim trajnimin e përbaruesve gjyqësorë;
- b) Organizimin e seminareve, vizitave studimore, konferencave, “workshop”-eve në shkëmbimin e eksperiencave;
- c) Asistencë reciproke për çështje procedurale dhe materiale të lidhura drejtpërdrejt me shërbimin përbarimor.

Neni 3

Forma të tjera bashkëpunimi

- a) Palët angazhohen të ofrojnë këshillime, asistencë, ofrimin e materialeve mbështetëse në përgjigje të zhvillimeve aktuale të sistemeve respektive përbarimore.
- b) Palët angazhohen të llojnë në favor të njëra-tjetrës për çështje të interesit të përbashkët apo respektiv të profesionit përbarimor

Neni 4

Ndryshimi i Memorandumit

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin unanimit të të dy palëve dhe kohëzgjatja e tij është në vullnetin e lirë të palëve, sipas vlerësimit të tyre diskrecional.

Neni 5

Hyrja në fuqi e Memorandumit

Memorandumi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy Palët. Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi paraprak nga ana e çdo Pale.

Memorandumi mbahet në dy kopje origjinale për secilën prej palëve dhe në rast konfuziteti në interpretim do të prevalojë ai kuptim që jep përfundimin më të favorshëm për palët.

Neni 6

Përfaqësimi i Palëve

Secila prej palëve do të përfaqësohet prej kryetarit të dhomave kombëtare respektive ose sipas rastit prej përfaqësuesve të caktuar prej tyre, pjesë e shërbimeve respektive përmbarimore.

Neni 7

Ky memorandum bashkëpunimi nënshkruhet në datën 24.09.2016 në Kosovë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Për

**Dhomën Kombëtare
të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë**

Për

**Odën e Përmbaruesve
Privatë të Kosovës**

KRYETARI I DHOMËS KOMBËTARE

Z. Tedi MALAVECI

KRYETARJA E ODËS

Znj. Emine SHERIFI (LUBENIQI)